



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
REKTORATI

Nr 289/4 prot

Elbasan, më 29.01.2025

VENDIM

Nr 5, datë 29.01.2025

Për

një ndryshim në VBA-në nr. 15 datë 23.02.2024 "Për vendosjen e tarifave të tjera në Universitetin e Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani'"

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni nr. 3. Pika 3. ç), neni nr. 6, neni nr. 47, Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 2 datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar, Udhëzimit të MFE nr. 9, datë 20.3.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar, Vendimit të Senatit Akademik nr. 15, datë 23.02.2024 "Për vendosjen e tarifave të tjera në Universitetin e Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani'", Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Pas pikës 7) të shtohet pika 8) "Pjesëmarrje në konferenca me tarifë 3,500 lek". Tarifat për shërbimet e ndryshme që kryhen në Universitet të jenë sipas tabelës nr. 1.

Tabela nr. 1 Tarifat e shërbimit të ndryshme			
Nr.	Emërtimi i shërbimit	Njësia	Çmimi
1	Vërtetime diplomimi (para marrjes diplomës)	Lek	500
2	Certifikatë notash (dublikatë)	Lek	500
3	Programe mësimore	Lek/ Program	200
4	Librezë studenti	Lek	500
5	Diplomë me suportin e saj	Lek	1,000
6	Verifikim diplome	Lek	2,000
7	Pjesëmarrje në Konferencë Shkencore me kredite	Lek	5,000
8	Pjesëmarrje në konferenca	Lek	3,500
9	Referues i parë në Konferencë Shkencore	Lek	2,000
10	Referues bashkëautor në Konferencë Shkencore	Lek	1,000
11	Qira salle videokonference/leksione/trajnime	Lek/orë	2,000

2. Për secilin prej shërbimeve Drejtoria ekonomike të emetojë Formular për arkëtim.



3. Shtohet pika 3) me këtë përmbajtje: “Personeli akademik i UE-së (personeli akademik efektiv dhe personeli akademik i jashtëm), personeli akademik i ftuar (personel akademik i huaj ose personalitete), si edhe studentët pjesmarrës në konferencë, nuk paguajnë tarifa.
4. Ngarkohet Administratori i Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

